




Zgjedhjet Lokale në Veriun e Kosovës: Bllokadë apo Ri-integrim?

Qershor 2025

Ky raport bazohet në diskutimet që janë zhvilluar sipas rregullit të Chatham House.

Ky raport është realizuar me mbështetjen e Fondit Kombëtar për Demokraci (NED). Opinioni dhe pikëpamjet e shprehura në raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet e NSI-së, NED-it apo të pjesëmarrësve individualë. Ky është thjesht një përmbledhje e shkurtër e diskutimeve

Autore: Milica Radovanović

Redaktore: Jovana Radosavljević

Tabela e Përmbajtjes

**Kriza Institucionale dhe Politike Thellohet në
Veriun e Kosovës para Zgjedhjeve Lokale**

01

**Blokada Politike dhe Qëndrimet e Kundërta të Partive
Vështirësojnë Peizazhin e Qeverisjes në Kosovë**

02

**Marrëveshje Politike më e Gjerë dhe Përfshirja e Serbëve
të Kosovës – Thelbësore për Stabilitetin Afatgjatë**

03

Kriza Institucionale dhe Politike Thellohet në Veriun e Kosovës para Zgjedhjeve Lokale

Kosova aktualisht po përballet me një krizë institucionale dhe politike, e shoqëruar me pasiguri të shtuar dhe brishtësi në komunat e saj veriore. Ndërsa rajoni po përgatitet për zgjedhjet lokale, atmosfera mbetet e tensionuar, me përpjekjet për ri-integrim të penguar nga mungesat e vazhdueshme strukturore dhe të burimeve njerëzore. Paqartësia ligjore dhe ngecja administrative vazhdojnë ta karakterizojnë qeverisjen në veri, ku besimi i publikut në institucione po bie në mënyrë të qëndrueshme, i ushqyer nga perceptimet për drejtësi selektive dhe zbatim të pabarabartë të sundimit të ligjit.

Në këtë peizazh të brishtë, komuniteti serb në veri të Kosovës duket politikisht i lodhur dhe shoqërisht i tërhequr, duke thelluar edhe më shumë hendekun tashmë të madh mes komuniteteve lidhur me pritjet rreth ri-integrit. Komuniteti ndërkombëtar, megjithëse kyç për ruajtjen e një niveli të qëndrueshmërisë, shpesh ka luajtur një rol të paqëndrueshëm.

Në themel të këtyre sfidave qëndron një çështje më e thellë: mungesa e një marrëveshjeje të gjerë politike që do të ofronte një rrugë për paqe dhe integrim afatgjatë, e përkeqësuar nga mungesa e vullnetit politik, mungesa e mundshme e stimujve domethënës dhe rëndësia e ulët që i jepet rajonit në agjendat globale. E ardhmja e Kosovës mbetet e lidhur ngushtë me marrëdhëniet në zhvillim – dhe shpesh të tensionuara – ndërmjet Prishtinës, Beogradit dhe aktorëve ndërkombëtarë që vazhdojnë të ndikojnë formësimin e qeverisjes dhe legjitimitetit në rajon.

Bllokada Politike dhe Qëndrimet e Kundërta të Partive Vështirësojnë Peizazhin e Qeverisjes në Kosovë

Më 9 qershor 2025, në Civic Energy Center në Mitrovicën e Veriut u mbajt një tryezë diskutimi mbi gjendjen e qeverisjes lokale në komunat veriore të Kosovës dhe kontekstin më të gjerë politik para zgjedhjeve lokale të planifikuara për tetor. Ngjarja mbledhi së bashku aktorë të shoqërisë civile, ekspertë të politikave dhe përfaqësues të komunitetit ndërkombëtar. Diskutimi u përqendrua në pasojat institucionale dhe politike të mungesës katërvjeçare të udhëheqjes legjitime lokale në katër komunat me shumicë serbe në veri, si dhe në pritjet dhe sfidat e lidhura me procesin zgjedhor që po afrohet. Tryeza u mbajt në një kohë të pasigurisë së madhe politike kombëtare, duke shtuar kompleksitet në një peizazh qeverisës tashmë të brishtë.

Kosova aktualisht po kalon një periudhë pasigurie të thellë politike, e karakterizuar nga një boshllëk institucional që vazhdon që nga zgjedhjet parlamentare të shkurtit. Pavarësisht më shumë se 30 përpjekjeve, Kuvendi nuk është konstituuar, duke lënë institucionet kyçe në një gjendje pezull para një cikli zgjedhor që duket gjithnjë e më i pashmangshëm. Megjithatë ekziston teorikisht mundësia për një koalicion të ri qeverisës, zhvillimet e deritanishme sugjerojnë se zgjedhjet e përgjithshme të parakohshme janë më të mundshme sesa një marrëveshje për koalicion.

Opsioni i vetëm i mundshëm për një koalicion – ndërmjet Vetëvendosjes (LVV) dhe Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) – duket i pamundur, duke pasur parasysh qëndrimet publike të partive dhe dallimet e thella mbi çështje kyçe. Të gjitha konstelacionet e tjera të mundshme për koalicione janë jashtë loje. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shembull, është pozicionuar në një mënyrë që përjashton aleanca si me LVV-në, ashtu edhe me partitë e tjera opozitare, duke kufizuar praktikisht të gjitha skenarët për koalicion.

Nëse LVV dhe PDK do të vendosnin të bashkëpunonin, ato do të mund të formonin një qeveri numerikisht të qëndrueshme që do të kishte aftësinë të zgjidhte presidentin, por një koalicion i tillë do të përballej me dallime të mëdha ideologjike dhe programore, veçanërisht për sa i përket dialogut me Serbinë dhe marrëdhëniet me komunitetin ndërkombëtar.

Një pikë përplasjeje është edhe çështja e kohës së mbajtjes së zgjedhjeve lokale kundrejt atyre të përgjithshme. LVV është në favor të mbajtjes së zgjedhjeve të përbashkëta, duke e parë këtë si një mundësi strategjike për të përqendruar fushatën në zgjedhjet e përgjithshme – ku performon më mirë – për dallim nga zgjedhjet lokale, ku kandidatët e saj tradicionalisht kanë pasur rezultate të dobëta. Nga ana tjetër, si PDK ashtu edhe LDK preferojnë që zgjedhjet lokale të mbahen të parat.

LDK pritet të lansojë një platformë partiake me 15 pika, të cilën synon ta prezantojë përballë aktorëve të tjerë politikë në përpjekje për të rifituar pozicionin e saj para çdo gare zgjedhore.

Marrëveshje Politike më e Gjerë dhe Përfshirja e Serbëve të Kosovës - Thelbësore për Stabilitetin Afatgjatë

Çështja e ri-integrimit të komunave me shumicë serbe në veri të Kosovës mbetet e pazgjidhur dhe varet shumë nga përbërja dhe drejtimi politik i qeverisë së ardhshme. Po aq e rëndësishme është çështja e definimit të marrëdhënies ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal, veçanërisht lidhur me funksionimin e qeverisjeve lokale dhe të Policisë së Kosovës, e cila mbetet nën kontroll qendror. Kjo situatë komplikohet më tej nga çështja e pazgjidhur e pranisë së vazhdueshme të Njësive Speciale (NJSP) në veri – sidomos brenda ndërtesave komunale – duke ngritur shqetësime për pasojat afatgjata të vendosjes së tyre dhe nevojën për një zgjidhje institucionale të qartë.

Kthimi i kryetarëve serbë të Kosovës pritet të ndodhë pas mbajtjes së zgjedhjeve lokale në tetor, por kjo nuk nënkupton domosdoshmërisht një ri-integrim të mirëfilltë.

Përkundrazi, mund të sinjalizojë një lloj pasivizimi institucional, ku kryetarët marrin detyrën formalisht por shmangin angazhimin aktiv në qeverisje.

Ri-integrimi do të varet edhe nga disponueshmëria e stafit të kualifikuar, prej të cilëve shumë janë larguar nga sektori publik apo kanë emigruar. Administratat lokale aktuale në masë të madhe kanë punësuar persona të pakualifikuar, çka e komplikon perspektivën e një qeverisjeje efektive edhe në rast të ri-integrimit.

Statusi ligjor i disa vendimeve të marra nga administratat lokale aktuale në katër komunat veriore mbetet i diskutueshëm. Për shembull, vendimi për nënshkrimin e marrëveshjeve me ofrues rajonalë të shërbimeve mund të sfidohet, por është pak e mundshme që administratat e reja të përpiqen t'i anulojnë. Në vend të kësaj, pritet një ngecje institucionale dhe rezistencë pasive.

Ekziston gjithashtu shqetësimi për zbatimin selektiv të sundimit të ligjit, me një perceptim të rritur në publik se autoritetet qendrore veprojnë vetëm kur është politikisht e përshtatshme. Kjo ngre një çështje më të gjerë: si do të reagojnë autoritetet qendrore kur qeveritë e reja lokale të marrin vendime që perceptohen si “kundër interesave të Kosovës”?

Një faktor i rëndësishëm në bllokadën aktuale politike është mungesa e presionit nga komuniteti ndërkombëtar, veçanërisht nga Uashingtoni. Shumë aktorë duket se po presin sinjale më të qarta nga jashtë para se të marrin veprime vendimtare. Kjo qasje pasive pasqyron perceptimin se aktorët politikë kosovarë nuk janë plotësisht të fuqizuar apo të gatshëm për të ndërmarrë hapa të guximshëm pa nxitje nga jashtë.

Reagimi ndërkombëtar fillimisht ishte jashtëzakonisht i fuqishëm, me masa ndëshkuese të vendosura si reagim ndaj problemeve të qeverisjes në veri, veçanërisht në një kohë kur kishte rezistencë aktive dhe kërcënim për përshkallëzim. Megjithatë, meqenëse këto kërcënime janë zbehur, reagimet ndaj vendimeve të diskutueshme lokale janë bërë gjithnjë e më të dobëta dhe të paqëndrueshme – duke sugjeruar se, në mungesë të një destabilizimi të menjëhershëm, veprime të tilla nuk tërheqin më vëmendje apo shqetësim të madh ndërkombëtar.

Kjo pasqyron një problem më të thellë: e ardhmja e Kosovës – veçanërisht në lidhje me komunitetin serb të Kosovës – nuk mund të zgjidhet pa një marrëveshje më të gjerë politike. Modeli i përsëritur i hyrjes në negociata pa vullnet të vërtetë për kompromis mbetet një pengesë e madhe për përparim. Nuk mund të ketë zgjidhje të qëndrueshme pa përfshirje të mirëfilltë të serbëve të Kosovës në jetën institucionale dhe politike të vendit. Roli i tyre nuk është vetëm qendror për normalizimin e brendshëm, por gjithashtu ka peshë të madhe për të ardhmen e marrëdhënieve Kosovë-Serbi dhe stabilitetin më të gjerë rajonal. Në këtë kontekst, serbët e Kosovës nuk janë thjesht një çështje e brendshme, por një faktor kyç për arritjen e një normalizimi të qëndrueshëm.

Komuniteti serb në Kosovë është politikisht dhe shoqërisht i rraskapitur. Braktisja institucionale, largimi dhe përjashtimi i gjatë nga një qeverisje funksionale i kanë vendosur në një regjim mbijetese. Shumë individë të kualifikuar janë larguar dhe ka shumë pak kapacitet ose vullnet për t'u ri-angazhuar pa stimuj të fuqishëm.

Pritjet e komunitetit për ri-integrim dallojnë ndjeshëm nga ato të shumicës shqiptare. Ndërsa shqiptarët e Kosovës shpesh kërkojnë më shumë sesa çfarë serbët janë të gatshëm apo në gjendje të pranojnë, serbët kërkojnë ndryshime minimale ose kthim në status quo. Këto pritje të papërputhshme do të vazhdojnë ta pengojnë ri-integrimin e mirëfilltë përderisa të mos adresohen hapur.

Situata politike në Kosovë përkufizohet nga një marrëdhënie trekëndëshe ndërmjet Prishtinës, Beogradit dhe komunitetit ndërkombëtar. Asnjë nuk duket i gatshëm të heqë dorë nga ndikimi i vet, dhe përparimi i mirëfilltë duket i kushtëzuar nga një vizion strategjik më i gjerë, veçanërisht nga akterët ndërkombëtarë.

Ka një nevojë urgjente për një marrëveshje të re politike – e cila do të përkufizojë pritjet dhe kornizat afatgjata për bashkëjetesë dhe qeverisje. Pa këtë, paraliza institucionale e përsëritur, fragmentimi dhe mosbesimi i ndërsjellë do të vazhdojnë të përcaktojnë trajektoren e Kosovës.

Na ndiqni për të rehat e fundit



New Social Initiative
Nova Društvena Inicijativa



@nsimitrovica



@NSIMitrovica



@newsocialinitiative